

Përmbledhje joteknike e Raportit të Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis

Për aplikim për konsultim publik për leje mjedisi të tipit B, për veprimtarinë:
“Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, aktiviteti me ID 7.12.o
– Prodhimi i këpucëve, ku konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.”



Subjekti: ALBAN.DEL sh.p.k, me adrese aktiviteti:
Bashkia Durres, Katund I Ri (Adriatik), Bisht Kamez, 1198, nr pasuris 60/100,
Durres.

Ky raport u hartua nga: A Consultant Sh.p.k

Korrik 2025



Permbajtja

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI,.....	4
a. Hyrje.....	4
b. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.....	6
c. Flora & Fauna.....	6
d. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.	9
2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;.....	10
a. Uji, akuiferet.....	10
b. Relievi dhe klima.....	11
3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR; ...	13
a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.	13
b. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.....	13
c. Shkarkimet ne ajer.....	14
d. Zhurmat.	14
e. Fenomene te tjera.	14
f. Gjenerimi i mbetjeve.....	15
g. Ndikime ne biodiversitet.	15
4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;	16
a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.	16
b. Shkarkimet ne ajer.....	17
c. Zhurmat.	17
h. Fenomene te tjera.....	17
i. Gjenerim i mbetjeve.....	18
5. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT.....	19
6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;	32
7. TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;	32
8. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;.....	33

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS;	38
- Identifikimi i masave zbutese.....	39
- Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.....	41
10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË);	47
11. SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE.....	47
12. KONKLUZIONE	49
13. Licencae QKL-së, të A Consultant shpk dhe eksperteve qe kane hartuar raportin e VNM P-së.....	52

1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI,

a. Hyrje

ALBAN.DEL shpk, me nipt K91825012J, ka me shume se 15 vjet qe ushtron aktivitetin e saj per prodhim kepucesh, qepje, ngjitje, montim, dhe eshte filial i nje prej kompanive me te njohura ne treg Tod's International. Aktualisht subjekti zoteron nje leje mjedisore me PN-0678-07-2021, si subjekt i prodhimit te kepuceve ne Shkozet, Durres.

Alban.Del me ane te ketij dokumenti kerkon te aplikoj per konsultim publik per aplikim per leje mjedisi B për aktivitetin “Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, aktiviteti me ID 7.12.o – Prodhimi i këpucëve, ku konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.” Vendndodhja e propozuar e instalimit eshte ne: Bashkia Durres, Katund I Ri (Adriatik), Bisht Kamez, 1198, nr pasuris 60/100 Durres. Informacion me i detajuar i vendndodhjes se aktivitetit jepet si me poshte.




Figura 1 . Pamje nga google earth per vendndodhjen e aktivitetit nga larg.




Figura 2. Pamje e zmadhuar e vendit ku do te ushtrohet aktiviteti.

Pasqyrimi i koordinatave ku propozohet vendodhja e aktivitetit per prodhimin e kepuceve.

Pika	X	Y
1	4371751.199	4584350.829
2	4371918.686	4584431.805
3	4372051.318	4584176.585
4	4371883.832	4584095.609

b. Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.

Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Popullsia: Sipas censusit të vitit 2024, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 153.614 banorë ndërsa sipas regjistrimit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 457 banorë km² ndërsa sipas Rregjistrimit Civil është 680 banorë km². Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra Zona ku ushtron aktivitetin kompania, ne ne Lagjen 14, objekti I Ish Mish Gomes, Shkozet, Durres , eshte toke e zhveshur nga bimesia dhe kryesisht e mbuluar me barishte, me nje peisazh te zakonshem dhe nuk gezon ndonje status te vecante mbrojtjeje persa i perket flores, faunes, dhe habitateve te ndryshme. Ky vend eshte i njohur si nje zone industriale ku perreth subjektit ushtrojne aktivitetet e tyre ekonomike dhe subjekte te tjera.

c. Flora & Fauna

Durresi ka nje pozite gjeografike, ndërtim gjeologjik, kushte klimatike, siperfaqe ujore dhe toka te cilat kanë krijuar habitate të përshtatshme për botën e gjallë bimore e shtazore. Durrësit ndodhet në rajonin e tipit Mesdhetar me nje llojesheri te lart te flores dhe faunes. Më poshtë janë evidentuar të gjitha bimët dhe kafshët e njohura të sipërfaqeve tokësore dhe hapësirave ujore, të territorit bashkiak të Durrësit.

Flora. Durrësi bën pjesë në zonën e shkurreve mesdhetare, te përfaqësuar nga dafina, mareja, shqopa dhe nga shkurret te tjera në formën e kacubeve te veçanta. Pranë bregut te detit shtrihet një brez gjelbërimi me pisha te zhvilluara mire qe jane me moshe 80 vjeçare që pervec pishes se bute gjendet dhe pisha e egër me moshe dhe llojet te tjere bimesie shoqeruese te egra si mersina, shqopa, etj.

Gjate bregdetit gjendet një baze pyjore natyre prej shelgu me moshe 60-80 vjeçare, i alternuar me pyll artificial prej pishash e plepash me moshe 50 vjeçare.

Duke qene se rajoni ka nje klime te favorshme , kjo ka sjellur ne një bimësi te shumëllojshme që nga pishat, plepi, frasheri i zi, morina, palma dhe dafina, deri në bimët e tjera dekorative si: frasheri gjethengushtë, eukalipti, shelgu lotues, etj.

Në zonat me te larta te rrethit (p. sh. zona e Ishmit) rriten shkurre që i rrezojnë gjethet e tyre gjate stines se dimrit si: shkoza, murrizi, driza, etj. Në Xhafzotaj, Sukth, Gjipale, Spitall etj, rriten edhe bime te ulëta si: mullaga, hithra, lulekuqa, tatulla, kopra e egër, ndërsa gjethe delli, lulebasami, hithra, grami, rrodhja, netulla, bar pate rriten kryesisht në zonën e Shijakut, Maminasit, Katundi te Ri dhe Ishmit.

Përveç bimësisë pyjore që zë vend te rëndësishëm në bimësinë e rrethit, po kaq rëndësi kane edhe kulturat buqesore te përfaqësuar nga: gruri, misri, fasulja, ulliri, lule dielli, te cilat përhapjen me te madhe e kane në zonën e Shijakut, Maminasit, Spitalles, Sukthi. Pothuajse në te gjithë rrethin kultivohen perime si: speci, domatja, kastravec, bizelja, etj., dhe agrumet (portokalli, limoni) te cilat prodhohen me shume pergjate bregdetit. Me ne detaje disa nga speciet e flores me tipike jane:

Në rajonin e Pirunit dhe Bisht Kamez-Rodon shënohet mbulesë bimësh rezistente me *Crithmum maritimum* (sea fennel) dhe *Elymus pycnanthus*, të përshtatshme në habitatet e kripura bregdetare. Në kënetat kripore, ekzistojnë rreth 62 specie nga familje të ndryshme, si *Inula crithmoides*, *Limonium oleifolium*, *Juncus acutus*, *Halimione portulacoides*, dhe të tjera, me përqindje të lartë *Chenopodiaceae* dhe formacione saline. Pergjate bregdetit dhe zones kodrinore hasen pisha mesdhetare (përfshi aleppo dhe stone pine), si dhe pyje të përziëra me juniperë, shëlgje, lise, etj. Në habitatet detare pranë Kepit të Rodonit dhe Porto Romano, janë evidentuar *Cymodocea nodosa* (neptune grass) dhe fragmentarisht *Posidonia oceanica*, e cila vlerësohet si shenjë e cilësisë së ujit detar.

Fauna. Bota shtazore e Durrësit është e shumëllojshme, në varësi edhe të tërësisë së habitateve tokësore e ujore që gjenden në këto territore. Në grupin e faunës tokësore bëjnë pjesë gjitarët e tokës (mishngrënës dhe barngrënës), shpezët, zvarranikët, amfibët, insektet etj. Të gjitha kafshët tokësore të hapësirës territoriale të Durrësit dhe Maminasit, janë pothuajse të ngjashëm me ato të të gjithë Shqipërisë dhe mbarë Mesdheut.

Zona e Durrësit eshte e pasur me lloje të shumta shpezësh të tokës dhe ujit, sedentarë dhe shtegtarë. Një pjesë e madhe e shpezëve banojnë në këto territore në

mënyrë të përhershme e si të tillë, ata janë sedentarë. Kemi dy grupe shpendësh, ato që shtegëtojnë në distanca të vogla dhe në distanca të mëdha (shtegëtime ndërkontinentale). Shpendët që vijnë për të dimëruar në territoret e këtyre bashkive janë tushat, laureshat etj; nga rendi i harabelave rosat e patat nga rendi i patorëve ; disa shpendë nga rendi i pëllumbave të egër nga rendi shapkave dhe i gjelzave të ujit etj. Nga shpezët e grupit të dytë mund të përmendim disa lloje nga rendi i harabelorve, sic janë bilbilat , bilbilthat , bishtatundësit, dallëndyshet, bengat etj., ndërsa nga rendet e tjera shkurtat, turtujt etj. Pjesa më e madhe e shpezëve sedentarë i ndërtojnë foletë e tyre atje ku dimërojnë, por ka edhe shumë prej tyre që bëjnë migracione sezonale, kryesisht vertikale brenda vendit. Interesantë janë edhe migracionet ditore të shumë shpendëve, të cilët lidhen kryesisht me sigurimin e ushqimit. Krahas shpezëve të tokës, kemi edhe shpezët e ujit, që gjenden në ujërat bregdetare. Ato janë të familjes së rosave, patave, të shapkave etj. Në grupin e shpezëve të tokës bëjnë pjesë: Thëllëza e fushës, Shkurta etj. Bota e zvarranikëve është mjaft e pasur gjithashtu. Midis zvarranikëve të tokës përhapje më të madhe kanë breshkat, gjarpërinjtë dhe hardhucat. Breshkat e tokës përfaqësohen nga breshkat e zakonshme, si dhe gjarpërinjtë janë më të shumtë e më të shumëllojtë. Hardhucat, më e përhapur është hardhuca e mureve dhe zhapiku i gjelbër , që banon në vende të mbuluara me shkurre e ferra.

Zona ku do vendoset aktiviteti është ndertese dhe nuk ka asnje lloje faune edhe flore ne te.

Si perfundim mendo te themi se llojet kryesore te flores ne toke jane pisha medhetare, lisi, shelqu, ilqa dhe bari i reres (Crithmum, Elymus). Ndersa nga llojet qe rriten ne dete haset Posidonia oceanica, Cymodocea nodosa, algat Ulvaceae. Nder llojet kryesore te faunes nga shpendet hasen Pelikan dalmat, flamingo e madh, migratorë në laguna & kënetë. Te tjera lloje te faunes haset delfin, lloje te ndryshem peshqish (leveek, koce, lice, barbun, kalamar, etj) dhe breshka detare ne det qe eshte lloj I rrezikuar. Ne toke hacen zvaranik si bolla, bullari, neperka, edhe breshka e zakonshme, hardhuca, etj. Hacen edhe gjitare si dehlpra, cakalli, iriqi, minj, uritha, etc.

d. Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.

Siperfaqja qe shfrytezohet eshte zone fushore, terreni eshte i sheshte, ku mungon tektonika. Mjedisi perreth eshte i sistemuar me lulishte dhe peme, ne te gjithë siperfaqen e lire. Peisazhi eshte i njejte me ate egzistuesin.

Territoret e bashkisë së Durrësit përfshihen në Përkuljen Pranadriatike. Karakteristike janë depozitimet terrigjene, të periudhës neogjenike dhe depozitimet aluvionale, detare dhe lagunore-kënetore të periudhës kuaternare. Shkëmbinj të terrigjenë përfaqësohen nga molasat neogjenike, të moshës tortoniane, mesiniane dhe suitës Helmesi të pliocenit. I rëndësishëm është trajtimi i tyre sipas periudhave gjeologjike.

Ne fotot e meposhtme jepen disa pamje te cilat ndodhen ne afersi te subjektit :



Figura 3.Pamje ne pjesen perpara godines.



Figura 4.Pamje e pjeses anesore e cila perkon me mjediset e parkimit

Ne paragrafet e meposhtem do te pershkruhen ndikimet e mundshme qe aktiviteti mund te kete kryesisht gjate funksionimit te tij ekonomik.

2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

a. Uji, akuiferet

Ne zone nuk ka burime siperfaqesore apo nentokesore ujerash, apo shpime te ndryshme te kryera per qellime hidrogjeologjike. Gjate funksionimit te aktivitetit nuk parashikohen shkarkime mbeturinash te demshme ndotese, ne ajer dhe ne toke. Territoret e bashkisë së Durrësit bëjnë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Erzen, Ishëm dhe në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Kurrizi kodrinor Rodon-

Erzen shërben si kufi ndarës i pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve të mësipërm. Pjesë të caktuara të fushës së Durrësit, të cilat kanë pjerrësi të vogël nga niveli i detit, i derdhin ujërat direkt në detin Adriatik. Rrjeti hidrografik sipërfaqësor përfaqësohet nga deti Adriatik, lumenjtë (Erzen dhe Ishëm), përrrenjtë, prroskat, liqenet bregdetare dhe objektet ujore artificiale si: ujëmbledhësit dhe kanalet kullues të ndërtuar mbas vitit 1950. Territoret e bashkisë së Durrësit kanë shtrirje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore. Ujërat nëntokësore gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës. Cilësia e ujërave nëntokësore nuk është e mirë për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm. Ujërat nëntokësore kanë përmbajtje të lartë të kripave dhe kjo lidhet edhe me përzierjen e ujërave nëntokësore me ujërat detare, si rezultat i afërsisë së tyre. Zhvillimi i aktivitetit të propozuar nuk ndikon në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zonës.

b. Relievi dhe klima

Relievi i territorit të bashkisë së Durrësit konsiderohet fushorokodrinor. Fushat zënë 67% të sipërfaqes, ndërsa kodrat 33% të tyre. Territori fushor zënë pjesën qendrore, ndërsa territoret kodrinore gjenden në periferi të bashkive, sidomos në pjesën veriore, lindore dhe atë perëndimore. Lartësia maksimale mbi nivelin e detit është 269 m (afër fshatit Kuratni, bashkia Durrës). Nuk mungojnë as kriptodepresionet (2 m) në veri të fushës së Durrësit (bashkia Durrës). Lartësia mesatare është 135 m. Në tabelën e mëposhtme paraqitet lartësia hipsometrike e territoreve të Durrësit dhe të Shijakut. Relievi fushoro-kodrinor i këtyre bashkive është krijuar në kushtet e tektonogjenezën alpine dhe nën ndikimin e faktorëve të jashtëm. Si modelues kryesor të këtij relievi evidentojmë veprimtarinë detare dhe lumore. Mbi këtë bazë evidentojmë tipin gjenetike të relievit strukturor, lumor, bregdetar dhe erozivo-denudues.

Territoret e bashkisë së Durrësit, si pjesë territoriale e Shqipërisë, bëjnë pjesë në gjerësitë gjeografike mesatare. Dalja e gjerë në detin Adriatik, si pjesa më veriore e detit Mesdhe, i jep klimës tipare mesdhetare. Tipari dallues i klimës mesdhetare është ekzistenca e katër stinëve (pranvera, vera, vjeshta dhe dimri). Në formimin e klimës së vendit tonë në tërësi dhe klimës tipike në hapësirën territoriale të Durrësit e të Shkozetit kanë ndikuar rrezatimi diellor, qarkullimi i masave ajrore të përgjithshme dhe faktorët lokal. Ndikim dominues në formimin e klimës e ka energjia diellore e drejtpërdrejtë, deti Adriatik dhe relievi fushoro-kodrinor. Një ndikim më të vogël

ushtrijnë masat qarkulluese të ajrit, lloji i tokave, mbulesa bimore dhe veprimtaria e njeriut në këto territore. Sipas zonalitetit klimatik të përcaktuar për vendin tonë, territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shkozetit bëjnë pjesë në zonën e klimës mesdhetare fushore, nënzona qendrore. Kjo konsiderohet si një zonë që merr sasi të mëdha të rrezatimit diellor. Numri I diteve me diell është 340 dite. Vlerat më të mëdha të këtij rrezatimi i kanë muajt korrik dhe gusht me 324 orë në të 31 ditët e tyre, kurse vlerat më të vogla muajt dhjetor dhe janar 105-116 orë në 22-25 ditë 35 . Rezatimi diellor i ndikuar dhe nga faktorët lokal ka përcaktuar këto tipare të temperaturave të ajrit. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Muaji më i ngrohtë është korriku me temperaturë mesatare 23.8 °C. Dimri është i butë me ndikim të fortë detar. Temperatura mesatare e janarit lëkundet nga 7,5-8.2°C. Minimumet absolute zbresin deri në -6°C dhe -7°C. Temperaturat më të mëdha se 20°C zgjasin 150-160 ditë në vit dhe vendosen pothuajse në mënyrë të qëndrueshme nga muaji maj deri në 10-ditëshin e parë të tetorit. Periudha me ngrica është e shkurtër. Numri i ditëve të akullta është i kufizuar. Periudha e vegjetacionit (temperaturat mesatare mbi 10 °C) fillon mesatarisht në fillim të marsit dhe vazhdon deri në fillim të dhjetorit. Afërsia e zonës me detin bën që në pranverë ngrohja të jetë e ngadaltë. Tipari dallues i kësaj nënzone klimatike është dimri i butë dhe i lagësht dhe vera e nxehtë dhe e thatë.

Tabela 1. Te dhenat per klimen ne Durres.

Muaji	Avg high (°C)	Avg low (°C)	Avg mean (°C)	Precipitation (mm)
Janar	10	4	7	130 (mm)
Shkurt	12	4	8	115
Mars	15	6	10	100
Prill	18	9	14	95
Maj	23	13	18	75
Qershor	28	17	22	50
Korrik	31	20	25	30
Gusht	32	20	26	45
Shtator	27	17	21	75
Tetor	22	13	17	110
Nëntor	17	10	13	160
Dhjetor	12	6	8	140
Vjetore	—	—	~16 °C	~1125 mm

3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR;

Hartimi i këtij raporti VNM paraprake për subjektin ALBAN.DEL shpk është kryer për të vlerësuar ndikimet që aktiviteti pritet të ketë në mjedisin përreth gjatë fazës së instalimit të linjes për prodhimin e kepuceve si dhe gjatë fazës së funksionimit të tij të metejshëm. Nga procesi i zhvillimit të aktivitetit nuk pritet të ketë ndikime negative të shkarkimeve nga përdorimi i ujit për qëllime higjieno-sanitare si dhe përdorimi i ujit në tualeteve në ujërat sipërfaqësore.

a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre në tokë.

Të gjitha mjediset kufizuese të jashtme të kantonit të prodhimit të kepuceve janë të shtrëna me beton. Vendndodhja është përcaktuar si zonë industriale në planin e zhvillimit urban të Njesisë Katund i Ri (Adriatik).

Gjatë fazës së instalimit të linjes dhe funksionimit të saj nuk pritet të ketë ndikime dhe shkarkime në tokë nga zhvillimi i këtij aktiviteti. Instalimi i linjes për prodhimin e prodhimit të kepuceve kryhet nga inxhinierë të specializuar.

Gjatë fazës së instalimit të aktivitetit, deri në fillimin e aktivitetit në prodhimin e kepuceve do të ketë prezencë të inxhinierëve të huaj për t'u siguruar që linja është në rregull me pas aktiviteti do të kontrollohet nga inxhinierët e brendshëm të fabrikës.

Në mjedisin përreth (toka kryesisht) nuk pritet që të ketë ndikime negative siç e kemi përmendur dhe me lartë pasi të gjitha proceset do të realizohen brenda magazinës (kantonit) ku do të instalohet linja e prodhimit të kepuceve (montim, ngjitje).

b. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre në ujë.

Nga zhvillimi i aktivitetit të "Fabrikës për prodhimin e kepuceve" nuk kemi gjenerim apo shkarkime të ujërave teknologjike në sistemin ujor. Ujërat e vetëm që do të përdoren do të jenë ato për qëllime higjieno-sanitare të punonjësve.

c. Shkarkimet ne ajer.

Subjekti ALBAN.DEL ka rreth 15 vite ne tregun Shqiptar qe jep kontributet e tij ne rritjen dhe permiresimin e gjendjes ekonomike te banoreve perreth zones ku ai ushtron aktivitetin e fasonerise. Ne vazhdimesi drejtuesit e kompanise kujdesen per te permiresuar mjediset e punes si edhe per te ulur dhe menjanuar shkarkime ne ajer dhe ne mjedis. ALBAN.DEL shpk me pajisjen me lejen mjedisore, do te monitoroj shkarkimet ne ajer per te identifikuar ndikimet e mundshme qe mund te shkaktohen nga ushtrimi i aktivitetit per prodhimin e kepuceve. Subjekti do te monitoroj emetimet ne ajer per percaktimin dhe asesimin e pluhurave totale SPM si dhe cilesine e gazeve per elementet: benzen, SO₂, NH₃, O₃ etj. Synimi eshte qe rezultatet e nxjerra nga monitorimet te jene me te ulta se normat e paracaktuara mjedisore ne fuqi. Perfaqesuesit e kompanise do te punesojne staf te specializuar dhe te pergjegjshem per te gjitha vendet e punes. Te gjitha keto masa do te merren nga subjekti dhe do te ndikojne ne permiresimin e ushtrimit te aktivitetit si dhe ne ofrimin e sherbimeve sipas standarteve me te mira ne tregun Shqiptar.

d. Zhurmat.

Gjate ushtrimit te aktivitetit ekonomik ner mjediset Alban Del shpk pritet te kemi gjenerim te zhurmave. Subjekti do te kryej monitorimin e zhurmave nje here ne gjashte muaj per te vleresuar ndikimet e mundshme ne mjedis.

Ndikimet negative qe mund te vijne nga krijimi i zhurmave ne raste avarishe jane:

- Reduktimi i eficences ne pune dhe lodhja.
- Rritja e presionit te gjakut;
- Shurdhimin e perkohshem apo te perhershem;
- Mekaniket, shoferet, manovratoret, punonjesit qe jane prane ambienteve te zhurmave, te gjitha mund te kene demtime ne sistemin e degjimit;

Duke qene se zhurma shkakton mungesen e perqendrimit te njerezit kjo mund te beje qe ata te harxhojne me shume kohe ne perqendrimin e tyre per te realizuar detyrat e tyre duke sjelle keshtu mbi-lodhje.

e. Fenomene te tjera.

Nuk aplikohet.

Vibracioni, nxehtesia, radiacioni, ndricimi verbues etj, nuk jane te pranishem gjate zhvillimit te ketij aktiviteti.

f. Gjenerimi i mbetjeve

Nga zhvillimi i aktiviteti te subjektit ne fjale do te gjenerohen mbetje te cilat do te lidhen me mbetje te krijuara nga gjysme prodhimi, si dhe mbetje te ngjashme me ato urbane. Listimi i ketyre mbetjeve do te detajohet ne kapitullin 4.

g. Ndikime ne biodiversitet.

Meqenese aktiviteti i prodhimit do te ushtrohet brenda dhe ne teritorin e sistemuar te kompanise nuk pritet te kete ndikime ne biodiversitetin e zones.

4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;

a. Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.

Subjekti ALBAN DEL shpk nga zhvillimi i aktivitetit Prodhim kepucesh (prerje, qepje, ngjitje) nuk do te ket shkarkime ne ujerat siperfaqesore. I gjithë aktiviteti do te kryhet ne mjediset e brendeshme te nderteses te marre me qera. Brenda mjedisese kryhet larja e dyshemese por keto ujera shkarkohen me pas ne sistemin e gropave septike te kompleksit.

Tabela 2. Evidentimi i ujerave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujerave te ndotura?		X	Nga ky aktivitet nuk ka ujera te ndotura. Te vetme ujera te perdorura jane ujerat qe perdoren per qellime higjiene dhe pastrimit te ambjenteve te kompanise.
A ka ujera te ndotura me natyre toksike?		X	Nuk ka.
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve?		X	Kompleksi eshte pajisur me gropa septike.
A behen shkarkime ne siperfaqet ujore?		X	Jo
Jepni sasine e ujerave te ndotura (m ³ / dite)	X		2 m ³

b. Shkarkimet ne ajer.

Nga shkarkimet ne ajer nga burimi pikesor pritet qe te gjenerohet perqendrimi i pluhurit total dhe fraksionet e PM₁₀ si dhe cilesia e gazeve (NO, NO₂, SO₂, CO). Subjekti do te kryeje nje monitorim jo te vazhduar per aplikimin per leje mjedisore per te vleresuar nivelin e perqendrimit te parametrave te cilat nese nuk mbahen nen kontroll ne nje te ardhme mund te sjellin pasoja ne shendetin e punonjesve dhe mjedisin perreth.

Per aktivitetin e subjektit Alban Del shpk nuk aplikohet kjo pike e kerkeses per leje mjedisore.

c. Zhurmat.

Gjate fazes se funksionimi burimet kryesore te gjenerimit te nivelit te zhurmave pritet te jene;

- o Nga levizja e automjeteve te transportit te lendeve te para,
- o Mjetet qe do sherbejne per ngarkimin e produktit
- o Zhurmat qe do te gjenerohen nga aktiviteti i fasonerise.
- o Automjete qe kalojne ne rrugen afer me subjektin

Tabela 3. Zhurmat gjate aktivitetit te subjektit

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma?	Po		Cdo aktivitet ekonomik sjell gjenerim te zhurmave. Duke qene se poceset kryesore te punes do te kryhen ne ambiente te mbyllura dhe ku procesi do te jete i automatizuar pritet qe rezultatet e testimit te nivelit te zhurmave te krijuar te jete brenda limiteve ditore te lejuara.
A gjenerohen vibracione?		Jo	Nuk ka vibracione

h. Fenomene te tjera.

Nuk aplikohet.

i. Gjenerim i mbetjeve

Gjate zhvillimit të aktivitetit të prodhimit të kepuceve pritët që të gjenerohen mbetje. Mbetjet me të zakonshme të Alban.Del jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4 Asgjësimi/trajtimi i mbetjeve të tjera				
Mbetja	Numri i katalogut	Trajtim i metejshëm në vendndodhje	Ripërdorimi, riciklimi ose trajtimi në vendndodhje	Metoda e asgjësimit/trajtimit në vendndodhje
Mbetjet që vijnë nga veshjet dhe lustrimet	04 01 09	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar nga operatore të licensuar
Mbetje ambalazhi plastike (kuti mastici plastike)	15 01 02	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar nga operatore të licensuar
Mbetje ambalazhi metalike	15 01 04	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar nga operatore të licensuar
Leter dhe karton	20 01 01	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim në venddepozitimin e Njesise Vendore
Qelq	20 01 02	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim në venddepozitimin e Njesise Vendore
Tekstilet	20 01 11	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim dhe asgjësim përfundimtar nga operatore të licensuar
Plastikat	20 01 39	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim në venddepozitimin e Njesise Vendore
Mbetje urbane të paspecifikuara	20 03 99	Nuk kryhet trajtim në vendndodhje		Grumbullim, transportim në venddepozitimin e Njesise Vendore

ALBAN.DEL shpk ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me subjektin “Alpen Pulito” për të larguar mbetjet e gjeneruara në subjekt. Subjekti do të krijojë regjister të regjistrimit të gjenerimit të mbetjeve për çdo muaj.

5. PERSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

Subjekti ALBAN.DEL Sh.p.k. pajisur me nipt: K91825012J, rregjistruar ne QKR ne dt 25/06/2009, me aktivitet kryesor_Prodhimin e kepuceve dhe produkteve te lekures, materialeve sintetike, materialeve baze si dhe te cilitdo perberesi tjeter dhe/apo aksesori per kepuçari dhe galanteri ne regjimin e perpunimit aktiv. Subjekti ALBAN.DEL sh.p.k eshte filial i nje prej kompanive me te njohura nderkombetare Tod's International B.V ne prodhimin e kepuceve (operon ne treg, kryesisht per shtresen e larte te shoqerise ne mbare boten). Disa nga brandet kryesore te grupit TOD'S (TOD'S, HOGAN, dhe FAY) dhe brandi i licensuar (ROGERVIVIER). Aktiviteti kryesor eshte krijimi, prodhimi, dhe shperndarja e kepuceve dhe aksesoreve te ndryshem.

Kapaciteti i aktivitetit. Kapaciteti do te jet mbi 5 t i perdorimit te solventeve për aktivitetin “Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, aktiviteti me ID 7.12.o – Prodhimi i këpucëve, ku konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.”

Subjekti ALBAN. DEL shpk aktualisht zoteron leje mjedisore:

- 1- PN-0678-07-2021 per “Prodhim Këpucësh (qepje, ngjitje, montim)” me vendndodhje në lagjia Nr.14, objekti i ish-NISH Gomës, Shkozë, Durrës; dhe

Aktiviteti i propozuar do te funksionoj sipas pershkrimeve te dhena si me poshte vijon;

Pershkrimi i instalimit. Subjekti ALBAN.DEL shpk ka 15 vjet qe ushtron aktivitetin e tij ekonomik ne tregun Shqiptar. Perfaqesues te aktivitetit kane implementuar teknologjine dhe pajisjet me moderne ne treg. Marka te cilen perfaqesojne ka percaktuar nje standart te cilen duhet ndjekur nga subjekti ALBAN.DEL shpk.

Te gjitha makinerite dhe pajisjet e vendosura ne mjediset e kapanonit te prodhimit te kepuceve ka kushtet me moderne te ushtrimit te aktivitetit ne fjale.



Figura 5. Pamje e zonave te punes

Metodat: Per percaktimin e metodave me te mira te ushtrimit te aktivitetit ekonomik subjekti ALBAN.DEL shpk ka implementuar eksperiencen e meparshme te kompanise Tod's International B.V.

ALBAN.DEL shpk eshte nje investim serioz qe i jep rendesi jo vetem ndjekjes se kerkesave te legjislacionit shqiptar, por edhe implementimit te praktikave me te mira te funksionimit ne fushen e fasonerise.

Alban Del ka krijuar kushtet me te mira te ushtrimit te aktivitetit. Magazina ka nje hapesine te konsiderueshme nga dyshemeja ne tavan gje qe siguron mjedisin e domosdoshem per cdo punonjes, ventilimin e mjediseve te punes dhe ndricimin e duhur.



Figura 6. Pamje e sigurimit te kushteve optimale ne mjedise pune

Kompania ka rivleresuar rrezikun ne pune si dhe ka shtuar nje aspekt te ri, ate te sigurise dhe shendetit te grave shtatezana dhe nenave te reja, si dhe lehtesira ne vendin e punes.

Procesi i punes nuk paraqet shkalle te larte rrezikshmerie. Punonjesit jane te deklaruar dhe te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi dhe kodit te punes. Ne subjekt zbatohen oraret sipas kodit te punes. Respektohen ditet zyrtare te punes. Ditet e pushimeve vjetore afishohen ne vende te dukshme ne fund te cdo viti del kalendari i ri. Menaxheri kryesor eshte personi pergjegjes i cili kryhen kontrollin ne fillim dhe ne fund te dites se punes te makinerive, si dhe ne rast te defekteve te pajisjeve eshte po ai qe kontakton me personat perkates.

Lendet e para.

Nder lendet e para qe perdoren per prodhimin e kepuceve per aktivitetin gjate shqyrtimit te kesaj kerkese jane:

- Pelhura elastike (zixhire, fije qepese,etj);
- Aksesore te ndryshem; dhe
- Ngjitesa apo bojera (per ti dhene shkelqim kepuceve).

Me poshte keto te dhena do te rregjistrohen si totale.

Tabela 5 Detaje mbi lëndët e para, materialet e ndërmjetme, produktet etj, që lidhen me proceset dhe përdoren apo gjenerohen në impiant/instalim.

Nr. Ref. ose Kodi	Materiali/ Substanca ¹	Numri CAS ²	Kategoria e Materialeve të Rrezikshme ³	Sasia që zakonisht magazinohet (t)	Përdorimi vjetor(t)	Konsumi për njësi produkti	Natyra e përdorimit	Kodi i Riskut R ⁴ -	Kodi i Sigurisë S ⁵ -
-	Zinxhire	-	-	-	14122	cope	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Shirit tekstili	-	-	-	5560	cope	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Etiketa tekstili	-	-	-	243987	cope	Ne formimin e kepuces	-	-

¹ Nëse materialet përfshijnë më shumë substanca të rrezikshme, jepni informacion të detajuar për secilën substancë

² Shërbim i Abstrakteve Kimike (CAS - Chemical Abstracts Service)

³ (Rregullore Nr. 1272/2008 (KE) për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzjerjeve) ose kategoria e Mbetjeve/Materialeve të Rrezikshmeve sipas Rregullores për Kategoritë e Mbetjeve duke përfshirë listën sipas legjislacionit përkatës shqiptar mbi mbetjet

⁴ Sipas Aneksit 2 të Udhëzimit të Kërkesës për Leje Mjedisi për kërkuesit

ALBAN.DEL SHPK


-	Pjese Metalike - Aksesore	-	-	-	143683 2	cope	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Lecka , spango, korda, litare dhe kablllo te mbetura	-	-	-	3000	meter	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Fije Qepese x Shuall	-	-	-	630010	meter	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Pelhure elastike	-	-	-	9000	meter	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Perforcues	-	-	-	902	meter	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Material Mbushes	-	-	-	1175	meter	Ne formimin e kepuces	-	-
-	Aksesore pjese per syprina	-	-	-	485591	pale	Ne formimin e kepuces	-	-

Adresa: TIRANE, Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2; Email: a.bakushi@todsgroup.com

Adresa: Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania

ALBAN.DEL SHPK



-	Boje	-	-	-	584	kg	Ne formimin e kepuces	-	-
-	AQUAGUM M/313	55965-84-9	3.2/1B Skin Corr. 1B H314 3.4.2/1-1A-1B Skin Sens. 1,1A, 1B H317 4.1/A1 Aquatic Acute 1 H400 4.1/C1 Aquatic Chronic 1 H410 3.1/3/Oral Acute Tox. 3 H301	-	1900	kg	Ne formimin e kepuces	-	-

Adresa: TIRANE, Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 2; Email: a.bakushi@todsgroup.com

Adresa: Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania

ALBAN.DEL SHPK



			3.1/3/Derma I Acute Tox. 3 H311						
			3.1/3/Inhal Acute Tox. 3 H331						
-	AQUAGUM M/500-F	-	-	-	70	kg	Ne formimin e kepuces	-	-
-	TERMOPLASTICO OROTERM	-	-	-	60	kg	Ne formimin e kepuces	-	-
-	DESMODUR	-	-	-	10	lt	Ne formimin e kepuces	-	-
-	SOLV. ORGANICO ESENTE GLICOLE	-	-	-	150	kg	Ne formimin e kepuces	-	-
-	EVO TEX 4740	-	-	-	80	kg	Ne formimin e kepuces	-	-

Adresa: TIRANE, Rruga Abdi Toptani, Torre Drin,
Kati 2; Email: a.bakushi@todsgroup.com

